



BALLINA

LAJME

VIDEO

BOTA

SPORT

OPINION

SHOWBIZ

LIFESTYLE

AUTO & TEK

FUN

ENGLISH

Goditet grupi kriminal, arrestohen tetë persona të dyshuar për përfshirje në krim të organizuar



04/07/2022 12:06



Policia e Kosovës ka arrestuar tetë persona të dyshuar për përfshirje në krim të organizuar.

Në një komunikatë për media thuhet se deri tek arrestimi erdhën pas një operacioni disa ditorë ndaj një grupi kriminal të përfshirë në disa vepra penale si: “Pjesëmarrja ose Organizimi i Grupit Kriminal të Organizuar” që lidhen me veprat “Shkaktim i Rezikut të Përgjithshëm”, “Zjarrvënie”, “Detyrim” etj.

“Të dyshuarit e arrestuar janë: A. P. dtl. 1999, K. K. dtl. 1998 , F. C. dtl. 2003, A.M. dtl. 1995, G. I. dtl. 1998, D.R. dtl. 2004, E.C. dtl. 1993, L.B. dtl 2000”, thuhet në njoftim.

Po ashtu, në komunikatë bëhet e ditur se cilat raste janë hetuar:

Rastet e hetuara dhe në të cilat dyshohet se janë përfshirë personat e dyshuar tani më të arrestuar janë, rasti i datës 19.06.2022, ku rreth orës 02:20 ka ndodhur një zjarrvënie në një lokal në “Dardani” të Prishtinës, ku dyshohej se zjarri ishte shkaktuar nga hedhja e një shisheje me benzinë (koktej molotovi), e cila kishte shkaktuar vetëm dëme materiale.

Me datë 22.06.2022, diku rreth orës 03:30, në të njëjtin lokacion afër këtij lokali në Prishtinë ishte hedhur një granatë dore e cila kishte shkaktuar vetëm dëme materiale në tri veturat të cilat ishin të parkuara.

Ndërsa me datën 06.06.2022, diku në ora 03:03, në rrugën “Shemsi Ahmeti” në Mitrovicë ishte hedhur një granatë dore e cila nuk ishte aktivizuar (shpërthyer). Granata në fjalë nga vendi i ngjarjes ishte tërhequr nga njësia përkatëse e PK-së.

Më datë 28.06.2022, diku rreth orës 03:30, në rrugën e Mullirit në Mitrovicë, ishte hedhur një granatë dore e cila kishte shkaktuar vetëm dëme materiale.

“Me veprime operationale të ndërmarra në vazhdimësi me datat 20.06, 22.06, 23.06, 27.06 dhe 03.07.2022 është arritur që të arrestohen tetë (8) personat e dyshuar për të cilët dyshohet se kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejtë në kryerjen e veprave penale të lartcekura”, thuhet në njoftim.

Në cilësi të prova materiale janë sekuestruar: tetë telefona mobilë, një veturë, 6.7 gramë subsancë narkotike si dhe prova të tjera materiale të cilat shërbejnë në procedurë të mëtejme.

Personat e dyshuar fillimisht me urdhër të prokurorit kanë qenë në mbajtje, pastaj sipas vendimit të Gjykatës u është vazhduar masa e paraburgimit për 30 ditë.

Artikuj të ngjashëm



July 4, 2022

Gjashtë të vdekur nga të shtënat në Paradën e 4 Korrikut afër Çikagos



July 4, 2022

Drejtori i Policisë dhe zv/ministri i Drejtësisë vizitojnë policët e plagosur...



July 4, 2022

Bordi i AKP-së vendos për shitje 34 asete të ndërmarrjeve shoqërore



July 4, 2022

Rama: Mark Rutte më mësoi që duhet ta dashurosh Evropën, por...



July 4, 2022

Nuredin Lushtaku dërgohet në mbajtje




July 4, 2022

Publikohet video, Nuredin Lushtaku nën prangat e policisë


LAJME TË FUNDIT



Dua Lipa ndan foto nga prapaskenat e festivalit,...



Zyrtare: Ardi Ajdini te Prishtina



Gjashtë të vdekur nga të shtënat në Paradën e 4 Korrikut afër Çikagos



Real Madrid po përgatit kontratën e re për Rodrygo



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information